



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA E MBROJTJES SË TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE  
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. ~~3666~~ Prot  
3

Himarë, më 22.05.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. 29, datë 22.05.2026

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR  
PARANDALIMIN E SITUATAVE TË MUNDSHME NGA ZJARRET E  
KRIJUAR SI PASOJË E TEMPERATURAVE TË LARTA”**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 54, Ligjin Nr.44/2015 “Kodi Civil i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile”, VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”;

Këshilli Bashkiak Himarë pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Himarë;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë planin e masave për parandalimin e situatave të mundshme nga zjarret e krijuar si pasojë e temperaturave të larta.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Himarë, drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuara për këtë çështje.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 55, pika 6.

**PLAN – MASASH**

**Baza ligjore**

1. Ligji nr.45/2019, datë 18.07.2001, “Për Mbrojtjen Civile”
2. VKM nr. 94, datë 22.02.2023, “Strategjia kombëtare e Vlerësimit të riskut”
3. Ligji nr.152/2015, “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.
4. Ligji nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”

5. V.K.M nr. 807, datë 28.12.2023, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile”.
6. V.K.M nr. 168, datë 24.03.2023, “Vlerësimi i Riskut nga fatkeqësit natyrore”
7. V.K.M nr. 965, datë 02.12.2015, “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e Emergjencave Civile dhe Krizave”.
8. Ligji nr. 57, datë 30.04.2020, “Për pyjet”.

### Të përgjithshme

Sezoni gjatë verës dhe vjeshtës në Bashkinë Himarë, paraqet probleme të veçanta si pasojë:

- Rritjes së temperaturave të larta për një periudhë të gjatë, që ndryshojnë situatën në pyje dhe kullota, pemëtari, në zona rurale dhe urbane,
- Mbipopullim në sezonin e verës veçanërisht në bregdet,
- Shtim të fluksit të automjeteve, lëvizja neglizhente e njerëzve në bregdet,
- Neglizhenca në sjellje dhe reagim ndaj rreziqeve nga temperaturat e larta,
- Rritje të mundësive të rënies së zjarreve në zonat industriale, sidomos në fushën e hidrokarbureve si pasojë e avullimit të lartë.

Pyjet dhe kullotat në Bashkinë e Himarës, zënë një sipërfaqe prej rreth 40% të gjithë sipërfaqes totale të Bashkisë. Mos manazhimi i mirë i këtyre pasurive, ka bërë që gjatë sezonit pranverë-verë të vitit 2023-2024 dhe sidomos viti 2025, ka patur vatra dhe provokime zjarresh në shumë vende. Numri i zjarreve nga shkaqe natyrore është shumë i vogël. Rastet e zjarreve janë pothuajse nga dora e njeriut qoftë ato aksidentale ose me dashje.

Në Bashkinë Himarë, ka pasur raste të shumta zjarresh të qëllimshme për përfitimin e kullotave duke kërcënuar disa herë dhe spërfaqet që ndodhen në zona të mbrojtura me vlera kombëtare. Shpenzimet për fikjen e zjarreve nga toka ose me ndërhyrje nga ajri kanë qenë shumë të mëdha gjatë vitit 2025, kjo duke u nisur nga angazhimi kapaciteteve lokale dhe bashkive fqinje, i kapaciteteve FA me mjete efektiv dhe nga ajri ashtu dhe ato në kuadër të Mekanizmit European të Emergjencave.

Gjatë vitit 2025 zjarret kanë patur shtrirje pothuajse gjatë gjithë vitit. Zjarret kanë qenë në përgjithësi për djegie të mbetjeve në parcelat bujqësore ose në kullota. Zjarret janë shoqëruar me dëmtime në kullota, pyje, ullishte dhe dru.

Gadishmëria e mjeteve dhe personelit, marrja në kohë e sinjalit për zjarre dhe koordinimi, mbetet elementi kyç për fikjen shpejt të zjarreve dhe uljen e kostos për fikje.

### Detyra, probleme, përgjegjësi, afate

Nr.	Detyra, probleme në vëmendje ose për tu trajtuar	Kush e ndjek	Afati	Vërejtje
1	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Plani i Masave</li> <li>➤ Plani i veprimeve</li> <li>➤ Organizmi i takimeve me administratorët e njësisive të qeverisjes vendore,</li> </ul>	Sektori.M.C  Sektori.M.C Shërbimi pyjor, MZSH	30.04..2026 ----- Deri 10.05.2026 sipas grafikut	

	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Evidentimi nga administratorët lokal, të vatrave të rrezikuar për zjarre në ullishte dhe plantacione me frutikulturë, për një kujdes të veçantë.</li> <li>➤ Evidentimi i blegtorëve, zonat e patronazhit në pyje e kullota, tërheqja e vëmendjes për kujdesin dhe parandalimin e zjarreve.</li> <li>➤ Evidentimi i kapaciteteve njerëzore dhe mjeteve që kanë në dispozicion për kontribut për fikje zjarresh dhe gatishmëria e tyre për përballimin e situatave emergjente të shkaktuara nga zjarret në shkallë qarku.</li> <li>➤ Marrja e masave tekniko-organizative me të gjitha institucionet e pushtetit vendor ose qendrorë me detyrimet për emergjencat.</li> <li>➤ Të ripunohen të gjithë planet e emergjencave për sezonin, duke përfshirë në diskutim shoqërinë civile dhe komunitetin.</li> <li>➤ Sensibilizimi i opinionit publik me të gjitha mjetet e komunikimit lokal, shpërndarjen fletë palosjeve etj., në mënyrë që të reagojnë të gjithë ndaj këtij fenomeni shumë të dëmshëm për mjedisin dhe aktivitetin njerëzor.</li> <li>➤ Përcaktimi i saktë i detyrimeve për çdo institucion me varësi qendrore ose lokale për kontribut ndaj komunitetit në rast të emergjencave civile.</li> <li>➤ Koordinimi dhe detyrimin që ka Bashkia Himarë për masa konkrete për rritjen e sigurisë publike në zonat turistike, në zonat industriale, në zonat me lëvizje të shumtë mjetesh etj.</li> </ul>	<p>Shërbimi pyjor</p> <p>Sektori.M.C MZSH</p> <p>Sektori.M.C</p> <p>Sektori.M.C</p> <p>Bashkia Himarë</p> <p>Bashkia Himarë</p> <p>Sektori.M.C</p>	<p>30.05.2026</p> <p>30.04.2026</p> <p>30.04.2026</p> <p>10.05.2026</p> <p>30.04.2026</p> <p>15.05.2025</p> <p>Gjatë gjithë sesionit</p> <p>Në vazhdimësi</p>	
2.	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Prodhimi i fletë – palosjeve me destiancion për rritjen e sensibilizimit të banoreve të zonave</li> </ul>	Bashkia Himarë	25.05.2026	

	<p>rurale, zonave turistike, fermerëve, blegtorëve, te nxënësve në shkolla.</p> <p>➤ Trajtimi i problemeve që kanë dalë në vite dhe specifikat për çdo zone (<i>anët pozitive dhe negative</i>). Mundësit për të reaguar sipas zonave dhe rasteve.</p>	<p>Spektori.M.C MZSH Shërbimi pyjor</p>	<p>20.05.2026</p>	
3.	<p>➤ Njohja me të gjithë kapacitetet që kanë institucionet për kontribut në ngjarje të tilla.</p> <p>➤ Njohja e të gjithë institucioneve me varësi qendrore ose institucioneve lokale për detyrim që kanë në raste emergjencash të krijuara nga rënia e zjarreve.</p>	<p>Spektori.M.C  Spektori.M.C Shërbimi pyjor</p>	<p>10.05.2026  Në vazhdimësi</p>	
4.	<p><b>Takime për:</b></p> <p>➤ Zbatimin e detyrimeve të qeverisjes vendore, për përbalimin e emergjencave në sezonin e verës</p> <p>➤ Punë që duhet bërë me grupet e interesit në bazë fshati, njësie administrative, “<i>Për reagimin në raste emergjencash të shkaktuara nga zjarri, nga të gjithë faktorët që duhet të kontribuojnë në zbatim të ligjit</i>”.</p>	<p>Spektori.M.C  Spektori.M.C MZSH Shërbimi pyjor</p>	<p>Në Vazhdimësi  Në vazhdimësi</p>	
6.	<p>Krijimi i një bazë të dhënash për gatishmërinë e mjeteve Bashkëpunimin për marrje dhe dhënie informacioni në kohë me specialistët e emergjencave civile, strukturat mbrojtjes së pyjeve, policisë së shtetit, forcave të armatosura etj.</p>	<p>Spektori.M.C MZSH Shërbimi pyjor</p>	<p>20.05.2026</p>	
7.	<p>Informimi në kohë për çdo ngjarje Koordinimi i kapaciteteve për të ndërhyrë në kohë për parandalimin e situatave nga zjarret të mundshëm, në pyje kullota, në zonat rurale si dhe në zonat urbane, turistike, industriale etj.</p>	<p>Spektori.M.C MZSH</p>	<p>Sipas situatave</p>	
8	<p>Hartimi i planeve të bashkëpunimit të strukturave operacionale, zjarrfikëse, sektorëve etj.</p>	<p>Spektori.M.C</p>	<p>10.05.2026</p>	
9	<p>Situatat që mund të paraqiten në</p>	<p>Spektori.M.C</p>	<p>Në</p>	

	sezoinin e verës, shkaku i zjarrit, përgjegjësit institucionale duke ju referuar detyrimit ligjor. Raportimi të jetë i menjëhershëm në Q.K.O.E.C pranë A.K.M.C	MZSH Shërbimi pyjor	vazhdimësi për çdo situatë	
10	Të evidentojnë të gjitha rastet e emergjencave civile ta shkaktuara nga zjarret Të hapet libri i evidentimit të emergjencave civile Të evidentohet shkaku i ngjarjeve. Strukturat e angazhuara dhe zgjidhja e tyre. Anët pozitive të operacioneve Mangësitë dhe strukturat përgjegjëse Mos angazhimet dhe neglizhencat në veprim për plotësimin e detyrimeve. Analiza përfundimtare për përballimin e situatave të shkaktuara nga zjarret.	Sektori.M.C          Komisioni i emergjencave civile	Në vazhdimësi	

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Vangjel Tavo**

**ME DELEGIM DHE ME URDHER**  
**ZEVENDESKRYETARI**  
**Erifili Berberi**

